# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

***Qeveria - Vlada - Government***

***Ministria e Tregtisë dhe Industrisë***

***Ministarstvo Trgovine i Industrije- Ministry of Trade and Industry***

***Kabineti i Ministres - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister***

---

01 Ref. Nr. 71
Prishtinë, 18.05.2016

Ministrja e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike, nenit 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe Shtojcës 8 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive nxjerr:

**V E N D I M**

1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë jep pëlqim për themelimin e Zonës Ekonomike, respektivisht Parkut Industrial, në Qylagë të Lipjanit, duke u bazuar në faktin se kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi janë plotësuar.

2. Prona e paluajtshme në të cilën themelohet Zona Ekonomike në Qylagë të Lipjanit është e regjistruar në emër të Kuvendit Komunal të Lipjanit dhe është në sipërfaqe prej 562756 $m^2$.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Hykmete BAJRAMI**

**Ministre e Tregtisë dhe Industrisë**

Vendimi i dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të MTI-së;
- Kabinetit të Ministres;
- Kuvendit Komunal të Lipjanit;
- Agjencisë për Investime dhe përkrahjen e ndërmarrjeve;
- Departamentit Ligjor të MTI-së;
- Arkivit të MTI-së;